



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 1126/3 prot.

Tiranë, më 28.07.2023

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 1126/1, DATË 27.06.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASI Z. PËRPARIM THAÇI"**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e z. Përparim Thaçi, me nr. 901 prot., datë 03.06.2020 ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratëve z. E.K., prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe z. S.P., gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me vendimin nr. 1126/1, datë 27.06.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetase z. Përparim Thaçi", bazuar në nenin 122 pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendim duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Kamëz, 2, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Rruga: "Petrit Gaçe", banesa nr. 8, Kodër Kamëz";
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al).

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

